



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 21 mars 2012, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Salihe Mustafa, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi, Sasha Gjokiq, Liburn Aliu, Flora Brovina, Bahri Thaçi

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Florie Kryeziu - UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi Fikrim Damka - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 05.03. 2012,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe të punëkërkuesve,**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 05.03. 2012

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, pa vërejtje miratoi procesverbalin e datës 05.03.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Regjistrimin dhe Evidencën e të papunësuarve dhe të punëkërkesve

Fikrim Damka - Duke shpjeguar për procedurën që e ka përcjellë shqyrtimin e këtij Projektligji dhe duke konstatuar se nuk ka pasur vërejtje nga komisionet kryesore për Projektligjin dhe për amendamentet e propozuara, propozoi të miratohet raporti përfundimtar për Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe të punëkërkesve.

Komisioni njëzëri e miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe të punëkërkesve.

4. Të ndryshme

Fikrim Damka - I njoftoi anëtarët e Komisionit për një shkresë të pranuar nga FSSHK-ja, lidhur me një udhëzim administrativ të nxjerrë nga MSH-ja, për licencimin e përkohshëm të profesionistëve shëndetësorë.

Bahri Thaçi - Deklaroi se nuk ka kuptim licencimi i të huajve për shërbimet që mund të kryhen nga vendorët.

Salihe Mustafa - Tha se nëse ndodh kjo, atëherë për punëtorët tanë është konkurrencë dhe mund të mbesin pa punë.

Nazane Breca - U deklarua kundër licencimit të punëtorëve të huaj, derisa ne të kemi punëtorë tanë që mund t'i kryejnë ato punë. Licencim i përkohshëm të bëhet vetëm për kuadrot deficitare te ne.

Liburn Aliu - Tha se në këto çështje duhet të punohet me plan. Duhet të forcohen kriteret për licencim. Kjo bie ndesh me deklaratimet e ministrit për krijimin e shërbimeve publike shëndetësore.

Time Kadriaj - Deklaroi se deri tash ka ekzistuar një rregullore e licencimit të punëtorëve të huaj shëndetësorë. Nuk i di arsyet se pse po bëhet tash ky dokument.

Fikrim Damka - Propozoi të ftohet ministri i Shëndetësisë në Komision.

Komisioni vendosi ta ftojë në takim ministrin e Shëndetësisë

Flora Brovina - I njoftoi anëtarët e Komisionit për organizmin e një takimi për sigurimet shoqërore, më 27 mars 2012.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka